

Vendim nr. 262 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Genti Ibrahim, i,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **VLADIMIR SHYTI**, i përfaqësuar nga avokat Rezart Tërshana, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-2106 (206), datë 09.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, 18, 42, 43, 44, 49, 107, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, 141, 142 dhe 167 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27 dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka mbajtur pozicionin e specialistit në sektorë të ndryshëm të Ministrisë së Mbrojtjes nga viti 2004 deri në janar të vitit 2014, kur ka kaluar në listëpritje.

2. Me urdhrin nr. 205, datë 01.11.2012 të Kryeministrit “Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 94, datë 30.04.2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së

Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura”, struktura e ministrisë ka pësuar ristrukturim. Në bazë të atij urdhri, sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes ka njoftuar kërkuesin për kalimin në listëpritje, pasi sektori ku ai ishte në pozicionin e specialistit në atë moment do të suprimohej. Në vijim, me vendimin nr. 98, datë 08.01.2014 të sekretarit të përgjithshëm të ministrisë (*vendimi nr. 98/2014*) kërkuesi ka kaluar në listëpritje.

3. Ndërkohë, Kuvendi në datën 30.05.2013 ka miratuar ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (*ligji nr. 152/2013*), i cili parashikonte datën 01.10.2013 si momentin e hyrjes në fuqi. Me hyrjen në fuqi të tij u shfuqizua ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” (*ligji nr. 8549/1999*) dhe çdo dispozitë tjetër që ishte në kundërshtim me të. Gjatë kohës që pritej hyrja në fuqi e ligjit, Këshilli i Ministrave ka miratuar aktin normativ nr. 5, datë 30.09.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil””, me qëllim shtyrjen në kohë të efekteve të ligjit me 6 muaj pas hyrjes në fuqi, duke përcaktuar se deri në datën e fillimit të efekteve të tij do të zbatohet ligji nr. 8549/1999. Akti normativ ka hyrë në fuqi menjëherë dhe është miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 161/2013, datë 17.10.2013. Këto dy akte janë shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) me vendimin nr. 5, datë 05.02.2014 (*vendimi nr. 5/2014*), i cili ka hyrë në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare nr. 18, datë 26.02.2014.

4. Kërkuesi, duke mos qenë dakord me vendimin nr. 98/2014 për nxjerrjen e tij në listëpritje, i është drejtuar gjykatës në datën 27.11.2014 me kërkesëpadinë me objekt kërkimi: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 98/2014; (ii) kthimin në vendin e punës apo në një pozicion të barasvlershëm me të ose në një pozicion më të ulët; (iii) detyrimin e palës së paditur për t’i paguar pagën paditësit nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në rikthimin e tij në punë.

5. Me vendimin nr. 706, datë 16.02.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Ajo gjykatë ka arsyetuar se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi ishte ligji nr. 8549/1999, ndaj dhe ajo është bazuar në parashikimet e tij në dhënien e vendimit. Duke mos qenë dakord me vendimin, kërkuesi ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit.

6. Me vendimin nr. 685 (634), datë 20.02.2017, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit të saj. Sipas asaj gjykate, në kohën kur pala e paditur ka nxjerrë vendimin nr. 98/2014, ligji që rregullonte marrëdhëniet e shërbimit civil ka qenë ligji nr. 152/2013. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs ministria dhe Departamenti i Administratës Publike, ndërsa kërkuesi nuk rezulton të ketë paraqitur kundërrekurs.

7. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2106 (206), datë 09.05.2024, ka marrë në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen e kërkuarit dhe në përfundim ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë.

8. Në datën 04.09.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës me ankimin kushtetues individual, sipas objektit. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuarit

9. **Kërkuari** ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka konkluduar se ligji i zbatueshëm në rastin e kërkuarit është ligji i vjetër për nëpunësin civil dhe në kushtet kur gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen në bazë të ligjit të ri, Gjykata e Lartë duhet ta kishte prishur vendimin e gjykatës së apelit dhe ta kishte kthyer çështjen për rigjykim me tjetër trup gjykues. Përkundrazi, ajo gjykatë ka marrë rolin e gjykatës së faktit dhe e ka shqyrtuar çështjen vetë, ndryshe nga sa ka vendosur në raste të tjera identike me të kërkuarit.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e

ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

11. Duke verifikuar kriteret paraprake në çështjen konkrete, Kolegji çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “F” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “I” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “F”, i Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

13. Për sa i takon kriterit *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 parashikon se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbi bazën e këtij standardi, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 09.05.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 04.09.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, ndaj çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

15. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë se thelbi i argumenteve të kërkuesit lidhet me qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Lartë në rastin e tij, duke e krahasuar atë me qëndrimin e mbajtur në çështje të ngjashme, çmon ta analizojë pretendimin e tij për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit, që *prima facie* hyjnë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohen në vijim së bashku për bazueshmërinë e tyre.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit

16. Sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë, në tejkalim të kompetencave të saj si gjykatë ligji dhe me një standard të dyfishtë, ka marrë në shqyrtim çështjen e kërkuesit, në vend që ta kthente atë për rishqyrtim në gjykatën e apelit.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë është theksuar se në ushtrimin e funksionit si gjykatë e ligjit, ajo gjykatë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i gjykatës së faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit (*shih vendimet nr. 57, datë 09.11.2023; nr. 15, datë 23.03.2023; nr. 44, datë 19.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjithashtu, Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se kur pretendimi lidhet me mënyrën e interpretimit të ligjit, ajo ndërhyt vetëm kur interpretimi është arbitrarisht ose kur konstaton gabim ligjor aq evident që të karakterizohet si një gabim që asnjë gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose të jetë i tillë që të prishë drejtësinë e procesit (*shih vendimet nr. 67, datë 06.12.2023; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet, provat dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, dhe në këtë drejtim, është theksuar se neni 141 i Kushtetutës i ka dhënë Gjykatës së Lartë kompetencën e shqyrtimit të çështjeve lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore sipas ligjit (*shih vendimet nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuarit, Kolegji do të verifikojë nëse në rastin në shqyrtim Gjykata e Lartë ka vepruar brenda kompetencave të saj si gjykatë ligji, si dhe nëse vendimi i saj është i arsyetuar, pa gabime

ligjore ose faktike të dukshme, pra nëse interpretimi i ligjit prej saj ka qenë haptazi i paarsyeshëm.

21. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2106 (206), datë 09.05.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë, pasi ka konstatuar se gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm lidhur me identifikimin e ligjit të zbatueshëm për nxjerrjen në listëpritje të kërkuarit, ka vlerësuar se ligji i zbatueshëm është identifikuar saktë dhe drejt prej gjykatës së shkallës së parë, në raport me datën e depozitimit të padisë në gjykatë dhe parimeve ligjore të zbatueshme. Ndërsa kuptimi që i ka dhënë gjykata e apelit shprehjes së ligjit se në momentin që shqyrton çështjen administrative, objekt gjykimi, është në fuqi vendimi i Gjykatës, nuk është në pajtim me zbatimin e parimit të efektit prapaveprues të vendimmarrjes së Gjykatës dhe është në kundërshtim të hapur me parimet e gjykimit administrativ, sipas saj. Ajo gjykatë ka vijuar në arsyetim se ligji nr. 152/2013 ka hyrë në fuqi në datën 01.10.2013, ndërsa vendimi i Gjykatës që e ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën ka hyrë në fuqi në datën 26.02.2014 (dhe nuk është shprehur për zbatimin e tij me efekt prapaveprues) kohë në të cilën çështja objekt shqyrtimi nuk ishte regjistruar ende në gjykatë dhe veprimi administrativ i kundërshtuar ishte mbështetur në ligjin nr. 8549/1999. Më tej, ai kolegji ka theksuar se ka një qëndrim të konsoliduar lidhur me shtrirjen e efekteve në kohë të vendimit nr. 5/2014 të Gjykatës, i cili është i zbatueshëm për tërësinë e çështjeve që kanë qenë në shqyrtim datën e hyrjes në fuqi të atij vendimi, pra në datën 26.02.2024, ndërsa ka konstatuar se padia e kërkuarit është regjistruar në gjykatë 9 muaj më vonë. Pas arritjes së këtij përfundimi për ligjin e zbatueshëm, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rastin konkret veprimi administrativ (kalimi në listëpritjeje) është kryer nga personi zyrtar përgjegjës, brenda kompetencave të përcaktuara në ligj, për raste shprehimisht të përcaktuara se kur nëpunësi civil del në lirim/listëpritjeje për efekt të ristrukturimit, dhe është kryer sipas formës dhe procedurës së parashikuar nga ligji nr.8549/1999, ndaj nuk mundet të konstatohet si veprim administrativ absolutisht i pavlefshëm. Në përfundim, ajo gjykatë ka vlerësuar se padia duhet të rrëzohet, përfundim në të cilin ka arritur edhe gjykata administrative e shkallës së parë (*shih paragrafët 33-38 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

22. Për sa më lart, Kolegji çmon se Gjykata e Lartë, duke identifikuar dhe interpretuar ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, si dhe duke zgjidhur përfundimisht në themel padinë, pasi më parë ka konstatuar se gjykatat më të ulëta kishin të njëjtë qëndrim për konstatimin e fakteve në mosmarrëveshjen administrative objekt gjykimi, ka vepruar brenda kompetencave kushtetuese të saj si gjykatë ligji. Në këtë mënyrë, Kolegji vlerëson se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që ai të ketë kundërthënie, të jetë i paqartë dhe të

mos ketë respektuar standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ndërsa në lidhje me argumentin se Gjykata e Lartë në rastin e tij ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi i mbajtur në çështje të ngjashme, Kolegji vë në dukje se interpretimi i ligjit të zbatueshëm nga Gjykata e Lartë në çështjen e kërkuarit nuk rezulton të ketë qenë arbitrar dhe në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e tij, pasi çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 47, datë 11.06.2024; nr. 19, datë 21.03.2024; nr. 17, datë 23.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në përfundim, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuarit për cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit është haptazi i pabazuar, për pasojë kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.